



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	10.10.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-390

**KËSHILLI DREJTUES**

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë, Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

**Kryesues i Këshillit Drejtues  
Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri**

**Prizren, më 09.10.2019**

Në mbështetje të Ligjit nr. 04/ L - 054 neni 6 paragrafi 8, dhe Ligjit nr. 04/ L - 261, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, , në mbledhjen e mbajtur me datë 20.09.2019, mori këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Lirohen me automatizëm nga pagesa e semestrave studentët që i takojnë kategorive si në vijim;

- Studentët e tri niveleve të studimeve që janë anëtarë të ngushtë të familjeve të dëshmorëve, të zhdukurve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së (ushtarak apo civilë) (neni 6, paragr. 8 Ligji Nr. 04/L-054).
- Studentët e tri niveleve të studimeve -Veteranët luftëtarë dhe fëmijët e tyre (neni 31 Ligji Nr. 04/L -261).
- Studentët e tri niveleve të studimeve që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës-Familjar të viktimave civile të luftës 1.1.1998 – 12.6.1999),
- Studentët me nevoja speciale në tri nivelet e studimeve,
- Studentët e nivelit baçelor dhe master, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale,

### Neni 2

Studentët të cilët i takojnë kategorisë a, b dhe c, duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Vërtetimin e noterizuar ( me vulë origjinale të noterit ) të lëshuar nga Komisioni qendror për njohjen e statusit të kategorive që kanë dalë nga lufta,dhe
- Çertifikatën e bashkësisë familjare.

### Neni 3

Studentët të cilët i takojnë kategorisë d dhe e, duhet t'i paraqesin këto dokumente:

a. Vërtetimin e noterizuar ( me vulë origjinale të noterit ) të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

b. Çertifikatën e bashkësisë familjare.

#### Neni 4

1. Shërbimi i studentëve në fakultet, obligohet që t'ua regjistroi pa pagesë semestrin përkatës të vitit akademik të gjithë studentëve të cilët i takojnë kategorive të sipërshënuara dhe të cilët i plotësojnë kushtet e specifikuar në këtë vendim.

2. Asnjë student që i takon kategorive të sipërshënuara nuk mund të lirohet nga pagesa në qoftë se nuk i ka dokumentet e kompletuara në përputhje me këtë vendim.

#### Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe do të vlejë deri në nxjerrjen e ndonjë vendimi tjetër.

Prof. Asoc. Dr. Beqir Mulaj

Kryesues i Këshillit Drejtues



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Menaxhmentit,
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Dekanëve të njësive akademike,
- Sekretarëve të njësive akademike,
- Zyrtarit ligjor të KD-së,
- Arkivit